

Sesioni trajnues në KLSH me ekspertët norvegjezë mbi auditimet e performancës 12-14 qershor

Në mjediset e KLSH-së u zhvillua në datat 12-14 qershor me ekspertët e performancës të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Norvegjisë, sesioni trajnues mbi zhvillimin e intervistave në auditimet e performancës si dhe përpunimi i analizimit të të dhënave të përftuara nga ato. Ky sesion trajnimi vijon në kuadër të aktiviteteve të parashikuara për këtë fushë në zbatim të marrëveshjes dypalëshe të bashkëpunimit.



Nga KLSH morën pjesë 21 auditues të Departamentit të Auditimit të Performancës dhe qasja praktike e tij kombinoi konceptet teorike me praktikën e më konkretisht:

- Në ditën e parë u parashtruan qasjet e praktikës nga secili auditues, shpërndarja e përvojës nga ekspertët e SAI-t të Norvegjisë, si dhe u zhvilluan ushtrime praktike, mbi intervistimin.

- Në ditën e dytë dhe të tretë, trajnimi ishte konceptuar si ndërveprim i pjesëmarrësve me njëri-tjetrin dhe me ekspertët e SAI-t të Norvegjisë për të nxjerrë në pah elementët që mund dhe duhet të përmirësohen gjatë zhvillimit të intervistave.

Audituesit e zhvilluan punën të ndarë në 5 grupe duke improvizuar situata të ndryshme lidhur me intervistimin, si dhe duke ndryshuar rolet mes njëri-tjetrit.

Një tjetër çështje e trajtuar ishte përpunimi dhe analizimi i të dhënave dhe informacioneve të përftuara përgjatë intervistave. Analiza Cilësore kolektive (Collective Qualitative Analyses) është një metodë e cila përdoret zakonisht në SAI-n e Norvegjisë në auditimet e performancës dhe konsiston në analizimin dhe vlerësimin cilësor nga i gjithë ekipi që merr pjesë në intervistën e zhvilluar me subjektin nën auditim.

Gjithashtu në këtë trajnim ekspertët e SAI-t të Norvegjisë sollën në vëmendje të pjesëmarrësve se ekzistojnë 4 lloje të ndryshme pyetjesh që përdoren në intervista të cilat janë “pyetje eksplorative”, pyetje “përshkruese”, pyetje “vlerësuese” dhe pyetje mbi shkaqet apo rastet e situatave të caktuara. Gjithashtu, një rëndësi të veçantë iu kushtua pyetjeve “të hapura” dhe “të mbyllura” që përdoren jo vetëm në intervista por edhe në pyetësorë.

Në përfundim, mësimet e nxjerra në këtë trajnim me qëllim vënien e tyre në praktikë në vazhdimësinë e punës tonë konsistuan në:

- rritjen e bashkëpunimit midis anëtarëve të grupit të auditimit;
- përgatitjen për zhvillimin e intervistave me subjektet nën auditim;
- ndarjen e roleve midis grupit të auditimit përgjatë zhvillimit të intervistave (si dikush drejton intervistën dhe bën pyetjet, dikush mban shënime, dikush ndërhyr me pyetje për çështje specifike etj.);
- përgatitjen e një përmbledhjeje mbi diskutimet në intervistë;
- dërgimin dhe marrjen e një “feedback-u” nga subjekti mbi këtë përmbledhje.